



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ÇËSHTJEVE DHE SHËRBIMEVE JURIDIKE**

Nr. 549/11 prot.

Tiranë, më 20.02.2023

URDHËR

Nr. 27, datë 20.02.2023

**"PËR
NGRITJEN E GRUPIT TË PUNËS PËR MONITORIMIN E SJELLJES SË
NËPUNËSVE CIVILË NË ZYRËN E INSPEKTORIT TË LARTË TË
DREJTËSISË GJATË PROCESIT ZGJEDHOR"**

Në zbatim të nenit 204, të pikës 1, të germës "c", të ligjit nr.115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, të neneve 5 dhe 37 të ligjit nr.152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, të ligjit nr. 9131, datë 08.09.2003 "Për rregullat e etikës në administratën publike", të vendimit nr. 9, datë 26.12.2020 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve "Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve",

KONSTATOVA SE:

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me shkresën nr. 153, datë 15.02.2023 "Mbi monitorimin e sjelljes së nëpunësve civilë gjatë procesit zgjedhor", ka udhëzuar Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për të ngritur grupin e monitorimit, me qëllim sigurimin e zbatimit të ligjit për nëpunësin civil, dhe vijueshmërinë normale të punës, së trupës së nëpunësve civilë, të pa ndikuar nga procesi zgjedhor, gjatë veprimtarisë së tyre.
Për këto arsye,

URDHËROJ:

1. Ngritjen e grupit të punës për monitorimin e sjelljes së nëpunësve civilë të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë gjatë fushatës zgjedhore, me këtë përbërje:

- a) Znj. Vilma Kola, Drejtor në Drejtorinë Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, Kryetar;
- b) Znj. Alma Zili, Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Arkiv Protokollit, anëtar;



c) Znj. Blerta Kërçuku Specialist në Sektorin e Hartimit të Akteve dhe Përputhshmërisë, anëtar.

2. Koordinator i grupit të punës për monitorimin, është znj. Alma Zili, me detyrë, Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Arkiv Protokollit, e cila komunikon me palët e interesuara në këtë proces, si dhe me Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

3. Grupi i Punës, deri në datën 20.02.2023, të hartojë rregulloren e brendshme të veprimtarisë së tij dhe të përcaktojë rregulla specifike për nëpunësit civilë gjatë periudhës zgjedhore, të cilën e paraqet për miratim tek Inspektori i Lartë i Drejtësisë.

4. Përcjelljen për njohje të këtij urdhri dhe rregullores “Për mbikëqyrjen e sjelljes nga grupi i punës për monitorimin e nëpunësit civil në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë gjatë periudhës së fushatës elektorale për zgjedhjet vendore, maj 2023, të gjithë nëpunësve civilë të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”.

5. Ngarkohet Koordinator i grupit të punës për monitorimin të informojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, brenda datës 22.02.2023, për miratimin e këtij urdhri dhe rregullores së grupit të punës për monitorimin.

6. Ngarkohet grupi i punës dhe Drejtoria Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse për njoftimin dhe publikimin e këtij urdhri, në faqen zyrtare të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Artur Metani

